

LIGJ PËR POZITËN JURIDIKE TË KISHËS, BASHKËSISË FETARE DHE GRUPIT RELIGJIOZ

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

(1) Me këtë ligj rregullohen themelimi dhe statusi juridik i kishës, i bashkësisë fetare dhe grupit religjioz, rregullimi i shërbesës fetare, i lutjes dhe ceremonisë fetare, i mësimit fetar dhe veprimtarive arsimore, të hyrat e kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz si dhe çështje të tjera.

(2) Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz janë të ndara nga shteti dhe janë të barabarta para ligjit.

Neni 2

(1) Kishë, bashkësi fetare dhe grup religjioz në kuptim të këtij ligji është bashkësia vullnetare e personave fizikë të cilët me bindjen e tyre fetare dhe burimet e mësimit të tyre e realizojnë lirinë e besimit fetar të bashkuar sipas fesë dhe identitetit të shprehur me kryerjen e njëjtë të shërbesës fetare, lutjes, ceremonive dhe shprehjeve tjera të besimit.

(2) Nëpunës fetar është personi i cili është me shërbim dhe me bindjen e tij fetare i takon kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz dhe kryen aktivitete ceremoniale - fetare, arsimore, organizuese dhe bamirëse në pajtim me normat e organit suprem të kishës së vet të regjistruar, të bashkësisë fetare dhe grupit religjioz, që janë në harmoni me Kushtetutën, ligjet dhe me rregullat juridike në Republikën e Maqedonisë.

Neni 3

E drejta e lirisë së besimit, mendimit dhe vetëdijes e përfshin lirinë e manifestimit të besimit ose bindjes së vet, që vetë ose së bashku me të tjerët publikisht ose privatisht e ka secili njeri.

Neni 4

(1) Nuk është i lejuar diskriminimi fetar.

(2) Bindja fetare nuk e liron qytetarin nga obligimet që i ka si qytetar sipas Kushtetutës, ligjeve dhe dispozitave tjera, përveç nëse kjo me ligj ose me dispozitë tjetër nuk është rregulluar ndryshe.

Neni 5

Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz kanë të drejtë që përbrenda lirisht të organizohen me organet e tyre të administrimit, hierarkinë dhe kompetencën, dhe të caktojnë persona të cilët do t'i përfaqësojnë dhe prezantojnë dhe të nxjerrin akte në lidhje me këtë.

Neni 6

Shteti e respekton identitetin e kishave, të bashkësive fetare, grupeve religjioze dhe format e tjera të bashkimit religjioz dhe me to vendos marrëdhënie të dialogut të vazhdueshëm dhe zhvillon forma të bashkëpunimit të përhershëm.

Neni 7

(1) Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz aktivitetet e veta i kryejnë në pajtim me dispozitat ligjore pozitive të Republikës së Maqedonisë, deklaratat ndërkombëtare dhe konventat për lirinë e besimit fetar dhe shprehjes së besimit.

(2) Organet shtetërore në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të veta krijojnë kushte për kryerjen e papenguar të aktiviteteve të kishës, të bashkësisë fetare dhe grupit religjioz.

Neni 8

Me ligj mund të kufizohet liria e shprehjes së religjionit ose bindjes nëse kjo është e domosdoshme në interes të sigurisë publike, rendit, shëndetit, moralit ose mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve.

II. STATUSI JURIDIK I KISHËS, I BASHKËSISË FETARE DHE GRUPIT RELIGJIOZ

Neni 9

(1) Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz, regjistrohen në Regjistrin themeltar gjyqësor të kishave, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze (në tekstin e mëtejme: regjistri kompetent), me çka fitojnë cilësinë e personit juridik.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për punët në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare mban evidencë për kishën e regjistruar, bashkësinë fetare dhe grupin religjioz.

(3) Në regjistrin kompetent regjistrohet kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz, nëse paraprakisht nuk është bërë regjistrimi i kishës, i bashkësisë fetare ose i grupit religjioz të tillë.

Neni 10

(1) Emri dhe shenjat zyrtare të çdo kisha, bashkësie fetare dhe grupi religjioz të ri, duhet të dallohen nga emërtimet dhe shenjat zyrtare të kishave, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze tanimë të regjistruara.

(2) Fjala "Maqedoni", fjalëformimet prej saj, si dhe përkthimet e kësaj fjale, pastaj stema dhe flamuri i Republikës së Maqedonisë, mund të futen në emrin dhe shenjat e kishave, të bashkësive fetare dhe grupeve religjioze në mënyrë me të cilën theksohet autoriteti dhe dinjiteti i Republikës së Maqedonisë. (3) Për përdorimin e emrit "Maqedoni", Ministria e Drejtësisë jep pëlqim me shkrim.

Neni 11

(1) Gjykatë kompetente për mbajtjen e Regjistrit themeltar gjyqësor të kishave, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze është Gjykata themelore - Shkupi II - Shkup.

(2) Të dhënat e shënuara në regjistrin kompetent janë publike.

(3) Ministri i Drejtësisë e përcakton formën dhe përmbajtjen e formularit të regjistrit kompetent dhe mënyrën e mbajtjes së tij.

Neni 12

(1) Regjistrimi në regjistrin kompetent bëhet në bazë të kërkesës.

(2) Me kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni dorëzohen: - procesverbali nga kuvendi i mbajtur themelues, - akti i themelimit, - akti me të cilin rregullohet statusi, organizimi dhe veprimi, - përshkrimi i burimeve të mësimit nga neni 2 paragrafi (1) i këtij ligji, - vendimi për caktimin e personit të autorizuar për përfaqësimin dhe prezantimin e kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz, - dëshmia për shtetësinë e themeluesve dhe personit të autorizuar që ta përfaqësojë dhe prezantojë kishën, bashkësinë fetare dhe grupin religjioz.

(3) Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz është i detyruar të caktojë person përgjegjës, i cili do t'i parashtojë regjistrin kompetent kërkesë për regjistrim në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së vendimit për themelim.

(4) Nëse me kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni nuk janë dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme, gjykata kompetente do ta ftojë parashtruesin e kërkesës që në afat prej 15 ditësh nga njoftimi t'i dorëzojë dokumentet e nevojshme, në të kundërtën kërkesën do ta hedhë poshtë.

Neni 13

Akti i themelimit nga neni 12, paragrafi (2), alineja 2 e këtij ligji përmban: - emrin dhe emërtimin e kishës, të bashkësisë fetare dhe grupit religjioz në Republikën e Maqedonisë, - selinë dhe adresën e kishës, të bashkësisë fetare dhe grupit religjioz në Republikën e Maqedonisë; - përshkrimin e shenjave dhe tipareve që do t'i përdorë kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz, - emrin dhe mbiemrin e personit i cili është i detyruar t'i parashtojë regjistrin kompetent kërkesën për regjistrim, - mënyrën e shprehjes së përkatësisë fetare dhe kryerjen e kultit religjioz dhe - financimin e kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz dhe pjesët e tyre përbërëse dhe mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes mbi disponimin financiar dhe material me mjetet.

Neni 14

Nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenet 12 dhe 13 të këtij ligji, gjykata e regjistrimit është e detyruar që në afat prej 8 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës ta regjistrojë kishën, bashkësinë fetare dhe grupin religjioz në regjistrin kompetent.

Neni 15

Aktvendimi me të cilin regjistrohet kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz përmban: - emrin ose emërtimin, - selinë dhe adresën dhe - emrin e personit që e përfaqëson dhe prezanton kishën, bashkësinë fetare dhe grupin religjioz.

Neni 16

(1) Nëse nuk janë plotësuar kushtet materiale sipas këtij ligji për regjistrimin e kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz, gjykata do ta hedhë poshtë kërkesën.

(2) Kundër aktvendimit me të cilin hidhet poshtë kërkesa, ankesë mund t'i dorëzojë gjyqit të shkallës së dytë vetëm parashtruesi i kërkesës në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Neni 17

(1) Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz i regjistruar, nëse ka marrë vendim për pushim ose shlyerje nga regjistri, është i detyruar që këtë t'ia paraqesë gjykatës kompetente për shlyerje nga regjistri kompetent.

(2) Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz i regjistruar, të gjitha ndryshimet në lidhje me elementet që regjistrohen në regjistrin kompetent janë të detyruar t'ia paraqesin gjykatës kompetente në afat prej 15 ditësh nga krijimi i ndryshimit.

III. SHËRBESA FETARE, LUTJA DHE CEREMONIA FETARE

Neni 18

(1) Kulti religjioz bëhet në objektet fetare si në tempull, xhami, shtëpi lutjesh, sinagogë, varreza dhe në hapësira të tjera të kishës, të bashkësisë fetare dhe grupit religjioz.

(2) Kulti religjioz mund të kryhet dhe të praktikohet edhe në hapësira të tjera dhe në vende publike.

(3) Shërbesa fetare, lutje dhe manifestime të tjera të fesë në objekte fetare ose në vende nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni mund të organizojë dhe të kryejë nëpunësi fetar i kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz në Republikën e Maqedonisë ose me lejen e tyre.

(4) Udhëtim pelegrinazhi është udhëtimi i organizuar i një grupi besimtarësh, nëpunësish fetarë në vende të shenjta nga ana e kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz. Gjatë organizimit të udhëtimit të pelegrinazhit organizatori është i detyruar që për grupin e besimtarëve, të nëpunësve fetarë t'i zbatojë dispozitat për mbrojtjen e popullsisë nga sëmundjet ngjitëse që kanë të bëjnë me mbrojtjen preventive.

(5) Çdo paraqitje e rrejshme si nëpunës fetar dhe keqpërdorim i uniformës fetare dhe i shenjave në regjistrin e kishës, të bashkësisë fetare dhe grupit religjioz nuk është i lejuar.

(6) Askush nuk guxon t'i pengojë personat klerikë dhe nëpunësit fetarë të kishave, bashkësive fetare dhe të grupeve religjioze në Republikën e Maqedonisë në kryerjen e aktiviteteve të tyre fetare në objektet fetare publike dhe aty ku kjo është e lejuar në pajtim me këtë ligj.

Neni 19

(1) Objekti fetar ndërtohet në bazë të kërkesës për marrjen e pëlqimit për ndërtim.

(2) Organet e komunave dhe Qyteti i Shkupit kompetentë për urbanizëm dhe miratimin e planeve urbanistike në procedurën para dhënies së pëlqimit për ndërtimin e objektit fetar mund të kërkojnë mendim nga kisha ekzistuese, bashkësia fetare dhe grupi religjioz, gjë e cila nuk është obligative për organin.

Neni 20

(1) Personat të cilët janë të vendosur në spitale, në shtëpi për fëmijë dhe shtëpi të personave të moshuar, hapësira dhe institucione ushtarake dhe policore, burgje dhe institucione të ngjashme mund ta shprehin besimin e tyre dhe me kërkesë personale të vizitohen nga klerikët për shkak të kryerjes së ceremonisë fetare dhe formave të tjera të manifestimit të religjionit ose besimit në pajtim me rendin shtëpiak në të cilin janë vendosur.

(2) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni mund të vizitohen nga nëpunësi fetar për shkak të kryerjes së ceremonive fetare.

(3) Institucionet e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni në kuadër të mundësive të tyre ligjore dhe hapësinore mund të ndajnë hapësirë në të cilën do të kryhej ceremonia fetare.

IV. MËSIMI FETAR DHE VEPRIMTARITË ARSIMORE

Neni 21

(1) Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz mund të mbajnë mësim fetar.

(2) Mësimi fetar mbahet në hapësira në të cilat kryhen ceremonitë fetare dhe mënyrat tjera për shprehjen publike të besimit, si dhe në hapësira dhe vende të tjera publike dhe private, nëse me këtë nuk priset rendi dhe qetësia publike.

Neni 22

(1) Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz ka të drejtë të themelojë institucione arsimore fetare të të gjitha shkallëve të arsimimit, përveç të arsimit fillor, për shkollimin e klerikëve dhe nëpunësve fetarë, si dhe shtëpi nxënësish dhe studentësh për vendosjen e personave të cilët shkollohen në ato institucione.

(2) Institucionet arsimore fetare janë të barabarta me institucionet tjera arsimore dhe nxënësit dhe studentët e tyre i kanë të drejtat dhe obligimet e njëjta.

Neni 23

(1) Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz është e detyruar që njoftimin për themelimin e institucionit arsimor fetar, me aktin për qëllimet dhe organizimin e brendshëm të shkollës dhe planin dhe programin mësimor në pajtim me dispozitat e këtij ligji t'ia dorëzojë organit kompetent për çështjet në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare së paku 90 ditë para ditës së caktuar për fillimin e punës së tij.

(2) Organi kompetent për çështje në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare është i detyruar që mendimin e tij t'ia dorëzojë kishës, bashkësisë fetare ose grupit religjioz, në afat prej 60 ditësh nga dita e marrjes së njoftimit.

Neni 24

(1) Planet dhe programet mësimore në institucionet arsimore fetare nuk guxojnë të jenë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjet.

(2) Organi i administratës shtetërore kompetent për arsimin mund të kryejë kontrollin e planeve dhe programeve mësimore në institucionet arsimore fetare në kuptimin e paragrafit (1) të këtij neni.

Neni 25

(1) Mësim në shkollë fetare mund të zhvillojë shtetasi i Republikës së Maqedonisë.

(2) Me përjashtim, nëse kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz kanë nevojë për kuadro adekuate, mësim në institucionin arsimor fetar mund të zhvillojë edhe shtetasi i huaj, në pajtim me dispozitat për qëndrimin e shtetasit të huaj në Republikën e Maqedonisë dhe me pëlqimin e organit kompetent për çështjet në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare.

Neni 26

(1) Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz në mënyrë të pavarur administrojnë me institucionet arsimore fetare dhe institucionet e tjera arsimore, si dhe me shtëpitë e nxënësve dhe studentëve, të cilat mund t'i formojnë në pajtim me këtë dhe me ligj tjetër.

(2) Personi përgjegjës në institucionin arsimor fetar, institucionin arsimor, shtëpinë e nxënësve ose të studentëve është i detyruar t'ia japë në dispozicion organit të administratës shtetërore kompetent për çështjet e arsimit të dhënat e nevojshme për kryerjen e kontrollit të punës së tyre, dhe në afat të caktuar nga ky organ t'i mënjanojë mangësitë eventuale.

Neni 27

(1) Në institucionet edukativo - arsimore mund të organizohet arsim fetar si lëndë zgjedhore në pajtim me ligjin.

(2) Gjatë përgatitjes së plan - programit mësimor me të cilin përcaktohet lënda zgjedhore nga sfera e arsimit fetar përmes organit kompetent për punët në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare mund të konsultohen kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz.

Neni 28

Arsim fetar si lëndë zgjedhore mund të zhvillojnë personat të cilët i plotësojnë kushtet e veçanta të parapara për këtë qëllim.

Neni 29

Nxënësit nën moshën 15 vjeçe mund të ndjekin arsimin fetar si lëndë zgjedhore në bazë të pëlqimit të prindërve ose kujdestarëve.

Neni 30

Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz mund të themelojnë institucione humanitare, kulturore, sociale, shëndetësore, bamirëse dhe lloje të tjera institucionesh, në procedurë dhe nën kushte të definuara me këtë dhe me ligj tjetër.

Neni 31

Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz mund të shfrytëzojnë mjetet për informim publik dhe të publikojnë, të importojnë dhe të eksportojnë publikime të botuara, si dhe të formojnë mjete vetjake për informim publik.

V. TË HYRAT E KISHËS, BASHKËSISË FETARE DHE GRUPIT RELIGJIOZ

Neni 32

Të hyrat e kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz janë nga: financimi vetjak, filantropia private, donacionet dhe nga forma të tjera të financimit.

Neni 33

(1) Kisha, bashkësia fetare dhe grupi religjioz vetë disponojnë me të hyrat e fituara, në pajtim me ligjin dhe me dispozitat e kishës, të bashkësisë fetare dhe grupit religjioz.

(2) Financimi i kishës, i bashkësisë fetare dhe grupit religjioz, si dhe harxhimi i mjeteve financiare është sipas rregullativës për organizatat jofitimprurëse dhe organizatat me interes publik.

VI. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 34

Ministri i Drejtësisë në afat prej 90 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji, do ta miratojë aktin për formën dhe përmbajtjen e formularit për regjistrimin në regjistrin kompetent dhe mënyrën e mbajtjes së tij.

Neni 35

(1) Organi kompetent për punët në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare është i detyruar që në afat prej 60 ditësh nga zbatimi i këtij ligji, t'ia dorëzojë Gjykatës Themelore Shkupi II - Shkup të dhënat dhe dokumentet për kishat, bashkësitë fetare dhe grupet religjioze ekzistuese të regjistruara në regjistrin e saj.

(2) Të gjitha kishat, bashkësitë fetare dhe grupet religjioze të regjistruara nga ana e organit kompetent për punët në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare deri më vitin 1998 mund ta mbajnë subjektivitetin dhe statusin juridik dhe të dhënat e tyre barten dhe shënohen në regjistrin kompetent në afatin nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 36

Në ditën e zbatimit të këtij ligji pushon të vlejë Ligji për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 35/97).

Neni 37

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë" ndërsa do të zbatohet nga 1 maji i vitit 2008.